

Znj. Leida Matja është zgjedhur anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës me Vendimin nr.29, datë 23.03.2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Znj. Matja ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës në vitin 1993. Ajo mban gradën shkencore Doktor i Shkencave Ekonomike, me specializim Marketing, që nga viti 2014.

Znj. Matja ka një përvojë të konsiderueshme profesionale dhe akademike.

Gjatë periudhës 2001-2002, ajo ka punuar për Bankën Gjermane për Rindërtim (Kreditanstalt fuer Wiederaufbau) si konsulente ekonomike.

Në periudhën 2001-2005 ka qenë Drejtuese e një Projekti të USAID, me anë të të cilit është bërë i mundur implementimi i 11 programeve për sipërmarrjen në të gjithë Shqipërinë.

Znj. Matja, që nga viti 1998 dhe në vazhdim, ka një kontribut akademik afatgjatë me punësimin e saj si Lektore e Marketingut në Universitetin e Tiranës dhe më pas në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ku gjatë periudhës 2012-2015, ajo ka mbajtur edhe pozicionin e Shefes së Departamentit të Burimeve Njerëzore për Turizmin.

Znj. Matja ka një aktivitet të gjerë në fushën e konsulencës për biznese dhe aktualisht është anëtare e Bordit të Shoqatës së Konsulentëve të Shqipërisë. Në periudhën 2012-2015, ajo ka qenë Presidente e Shoqatës së Turizmit Shqiptar, si dhe anëtare e Bordit dhe bashkëpunëtore respektivisht e Shoqatës së Grave Profesioniste, Afariste dhe Artizane, si dhe e Biznes Albania.

Znj. Matja, në fushën e saj të konsulencës, ka një bashkëpunim me shumë organizata të huaja si: UNDP, EBRD, ETF, etj, ku ka kontribuar me studime, vrojtime e konsulencia.

Znj. Matja, sot numëron me dhjetëra pjesëmarrje në konferenca, si dhe botime artikujsh në revista shkencore të mirënjohura.